



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 581/7 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr. 167, datë 30.12.2016

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin nr. 581/3 dt. 27.10.2016, të Komisionerit, për verifikimin e ligjshmërisë të veprimit administrativ të largimit nga puna të punonjësit **”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 90 dhe 185 i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të dokumentacionit, në lidhje me procesin e verifikimit të kërkesës nr. 581 Prot., dt.15.09.2016 të punonjësit të Bashkisë Selenicë, *****.

VËREJ SE,

Bazuar në informacionin që përmbante ankesa, e paraqitur nga shtetasi ***** , rregjistruar me nr. 581 prot., datë 15.09.2016, kanë lindur dyshime të arsyeshme se rasti i tij ishte trajtuar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, e për këtë arsye u urdhërua fillimi i procesit të verifikimit të ligjshmërisë të këtij rasti.

Mosmarrëveshja kishte lidhje me faktin që nëpunësi ***** , me detyrë “Përgjegjës i Zyrës Juridike dhe Administratës”, në Bashkinë Selenicë, është larguar nga detyra me aktin nr. 1866, dt. 11.10.2016, “Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënieve të punës”, të drejtuesit të institucionit, me motivacionin, për shkeljet e detyrimeve kontraktuale në punë. Ky nëpunës në këtë rast, pa të drejtë, nuk është trajtuar si nëpunës civil, por si punonjës me kontratë pune dhe është larguar nga puna në bazë të Kodit të Punës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rezulton se punonjësi ***** ka filluar punë disa muaj para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar. Për këtë shkak sipas përcaktimit të nenit 67/3 të këtij ligji, me të drejtë me aktin nr. 193/1, datë 07.04.2014, i është

deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës Civil Në Periudhë Prove*” në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës Juridike dhe Administratës*”, në Bashkinë Selenicë. Kjo marrëdhënie punësimi ka vazhduar deri në daljen e aktit nr. 1866 prot., datë 11.10.2016, “*Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënies të punës*”, me motivacionin shkelje e detyrimeve kontraktuale në mënyrë të përsëritur”.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se. gjatë periudhës së vazhdimit të marrëdhënies së punësimit, deri në daljen e urdhërit objekt ankimi, ka patur dy raste të mëparshme në të cilat, ndaj punonjësit, janë marrë masa disiplinore e konkretisht:

Me urdhërin nr. 352, dt.12.9.2013 nga ana e ish titullarit të institucionit është dhënë masa “*Vërejtje për pushim nga puna*” dhe më pas, me Urdhrin nr. 1484, dt.17.08.2016 është dhënë masa tjetër “*vërejtje*” për të njëjtat shkaqe, me pretendimin e mospërmbushjes së rregullt të detyrës, mosrespektimit të orarit të punës, mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, etj.

Dy masat e mësipërme disiplinore, pavarësisht se nuk janë ankimuar, vlerësohen të ligjshme nga pikëpamja e dispozitave procedurale dhe atyre materiale . Masa e parë, dhënë me aktin nr.352, dt. 12.9.2013, është marrë në një kohë që nëpunësi ***** nuk kishte fituar statusin e nëpunësit civil, për shkak të marrjes në punë në kundërshtim me ligjin që ishte efektiv në atë kohë (nr.8549 dt. 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”), prandaj me të drejtë janë përdorur dispozitat e Kodit të Punës.

Edhe masa e dytë “*vërejtje*”, (akti nr. 1484, dt. 17.08.2016), vlerësohet e bazuar në ligj, pasi nëpunësi në fjalë kishte përfituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit dhe në këtë rast, janë zbatuar dispozitat e neneve 58/a dhe 59/1 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Kryerja në vazhdim prej nëpunësit në fjalë, e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, të pretenduara prej eprorëve të tij, ka diktuar nisjen e një procesi tjetër disiplinor. Por këtë radhë, nga ana e drejtuesit të bashkisë dhe e njësisë përgjegjëse është vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Siç u tha dhe në pjesën e parë të këtij vendimi, punonjësi, ***** e ka përfituar statusin e nëpunësit civil bazuar në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe duhej të trajtohej në të gjitha drejtimet, si e tillë, si në kuptim të përfitimit të mundësive dhe të drejtave që përmban statusi i nëpunësit civil, ashtu dhe në drejtim të respektimit të procedurave të ndryshme që parashikon legjislacioni i shërbimit civil, për mënyrën e zhvillimit të karrierës, lëvizjeve paralele, ngritjes në detyrë, vlerësimit të punës, kryerjes së procedimit disiplinor, etj.*

Në rastin që shqyrtohet, në thelb jemi para një procedimi disiplinor, për të cilin në veçanti, në legjislacionin e shërbimit civil, parashikohen rregulla të përcaktuara në mënyrë të hollësishme. Konkretisht, një proces disiplinor fillon me momentin e vlerësimit të rëndësisë së shkeljes, në të lehtë, të rëndë dhe shumë të rëndë, sipas përcaktimit të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, pasi kjo lidhet ngushtë me kompetencën e organit që ka të drejtë të shqyrtojë këtë shkelje dhe të aplikojë masat disiplinore të përcaktuara në nenin 58, të ligjit në

fjalë, e cila determinon dhe mënyrën e procedimit të secilit organ disiplinor, siç përcaktohet në nenin 59 të tij.

Nga materialet e administruara, rezulton se shkak për këtë procedim disiplinor janë pretendimet e ngritura prej institucionit për “Shkelje të detyrimeve kontraktuale në mënyrë të përsëritur” nga ana e nëpunësit në fjalë.

Mbi bazën e këtyre pretendimeve, Kryetari i Bashkisë Selenicë me shkresën nr. 1809, datë 05.10.2016, ka njoftuar nëpunësin ***** për fillimin e procedurës të zgjidhjes së kontratës së punësimit, duke e trajtuar marrëdhënien konkrete të punës si marrëdhënie kontraktore dhe jo si marrëdhënie në shërbimin civil. Në vijim, Kryetari i Bashkisë Selenicë, me aktin nr. 1866 prot., datë 11.10.2016, “Për ndërprerjen e menjëhershme dhe të justifikuar të marrëdhënieve të punës”, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësin ***** me motivacionin “Shkelje e detyrimeve kontraktuale, në mënyrë të përsëritur”.

Veprimet e mësipërme të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, vijnë në kundërshtim me ligjin, pasi pa të drejtë, mosmarrëveshjen e lindur e ka trajtuar në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7691, dt.12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Një trajtim i tillë është i kundërligjshëm pasi në bazë të pikës 2, të nenit 1, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, “Marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative” dhe jo e natyrës kontraktuale. Kjo, ka ardhur si rrjedhojë e perceptimit jo të drejtë të natyrës së marrëdhënies së punës, gjë që ka diktuar edhe referencën e gabuar ligjore sipas nenit 144/1 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (shih aktin nr. 1809 dt. 05.10.2016 “Njoftim për fillimin e ndërprerjes së marrëdhënies në punës”).

Parë në këtë këndvështrim, eprori direkt, pasi ka marrë dijeni për shkeljet e përsëritura, duke u bazuar në rregullat e përcaktuara në Kreun X “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, ishte i detyruar të bënte vlerësimin paraprak të rastit dhe nëse çmonte që shkelja disiplinore e konstatuar ishte e natyrës së lehtë, në bazë të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ta fillonte dhe ta përfundonte vetë këtë procedurë, ndërsa në rastin që shkelja/shkeljet do të vlerësoheshin prej tij, si shkelje të rënda/shumë të rënda, në bazë të pikës 2, të dispozitës së mësipërme, duhej t’ja kalonte çështjen për shqyrtim Komisionit të Disiplinës.

Duke qenë se në rastin konkret, shkeljet e pretenduara se janë kryer nga ana e nëpunësit, janë konsideruar shkelje shumë të rënda, të tilla që kanë bërë të arrihet në përfundimin se marrëdhënia e punës nuk mund të vazhdojë më, drejtuesi i institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, duhej që çështjen t’ja kalonte Komisionit të Disiplinës, i cili do të ishte organi kompetent që mund të merrte një masë disiplinore të rëndë, siç është largimi nga detyra (largimi nga shërbimi civil).

Mosrespektimi i procedurës ligjore dhe marrja e kompetencave të Komisionit të Disiplinës nga ana e drejtuesit të bashkisë, në kuptim të pikës a), (nënpika i) dhe ii)), të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” janë shkelje të rënda të ligjit, që e bëjnë veprimin administrativ absolutisht të pavlefshëm, i cili nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, pavarësisht faktit nëse është konstatuar ose jo si i tillë (neni 110, pika 1, i ligjit nr. 44/2015).

Në bazë të nenit 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik (në këtë rast Kryetari i Bashkisë Selenicë) ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të kundërshtuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësit ******, sapo të vihet në dijeni nga ana e vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky është hapi i parë që duhet kryer prej tij për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë. Pas kësaj ai, me cilësinë e eprorit direkt, ka të drejtë të rifillojë procedurën disiplinore duke respektuar me korrektesë rregullat e përcaktuara në nenet 57, 58, 59 e 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, duke filluar me nxjerrjen e aktit të vlerësimit të natyrës së shkeljeve dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Komisionin e Disiplinës; ngritjen e Komisionit të Disiplinës, shqyrtimin e shkeljeve prej këtij të fundit dhe marrjen prej tij të vendimit përfundimtar.

Po kështu, parregullsi konstatohen edhe në veprimet e njësisë përgjegjëse, në lidhje me kryerjen e procesit të vlerësimit të punës së nëpunësit ******, në përfundim të periudhës së provës dhe më pas në krye të çdo 6-mujori, siç përcakton neni 62, pika 1, e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në dokumentacionin e dërguar nga ana e institucionit me shkresën përcjellëse nr. 2022/1 dt. 03.11.2016, ka vetëm një akt vlerësimi vjetor (për periudhën Gusht 2015 deri Gusht 2016). Ky akt vlerësimi është i parregullt, së pari se përfshin një periudhë kohore një vjeçare, ndryshe nga përcaktimi i dispozitës së përmendur në paragrafin e mësipërm, e cila kërkon vlerësime çdo 6 muaj. Për më tepër, sipas kuptimit të ligjit, vlerësimet pas përfundimit të periudhës së provës, duhet të jenë të realizuara vetëm në fund të muajve Qershor dhe Dhjetor, të çdo viti kalendarik dhe gjithë rubrikat e aktit të vlerësimit të punës, duhet të plotësohen me komentet përkatëse nga ana e zyrtarit raportues.

Të metat e parashtruara më sipër, përbëjnë elementë paligjshmërie të aktit, gjë e cila duhet të rregullohet duke u përsëritur gjithë procesi nga fillimi, për gjithë kohën, pas përfundimit të periudhës së provës (më konkretisht, Maj – Dhjetor 2015 dhe Janar – Qershor 2016).

Në këto kushte, nxjerrja e një akti administrativ në zbatim të një reference të gabuar ligjore (Kodi i Punës), pa respektuar procedurat për zhvillimin e një ecurie disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përbën një akt të nxjerrë në kapërcim të kompetencës dhe në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, gjë e cila në bazë të nenit 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është absolutisht i pavlefshëm dhe duhet anuluar.

Për këto arsye:

Në bazë të nenit 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; pikës a), (nënpika i) dhe ii)), të nenit 108, dhe nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Selenicë, të drejtojë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 1866, dt. 11.10.2016, *“Për largim nga puna”*, të punonjësit *****, nga vetë organi publik që e ka nxjerrë atë akt dhe kryerjen e gjithë veprimeve të nevojshme administrative për rregullimin e gjendjes, ku përfshihet anulimi i aktit të largimit nga puna nr. 1866 dt. 11.10.2016; kthimi i marrëdhënies administrative të cenuar në gjendjen e mëparshme dhe njohja e të drejtave ligjore të cenuara nëpunësit, nga akti i paligjshëm i largimit nga puna.
2. Të kërkoj nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Selenicë, të drejtojë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë të aktit të vlerësimit të pjesshëm të rezultateve në punë, për periudhën Gusht 2015 deri Gusht 2016, dhe marrjen e masave për përsëritjen e këtij procesi, sipas kërkesave të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, dt. 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*
3. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Selenicë si dhe nëpunësi Erjon Rapaj.
4. Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, brenda 30 ditëve të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA